

Karakteristikat e ushqyerjes së dhive të qumështit.

Dhitë karakterizohen nga një ushqyerje shumë përzgjedhëse, kapriçoze. Ato preferojnë ushqim të imët dhe të pasur me gjethë. Struktura dhe shija e ushqimit ndikojnë në konsumin e ushqimit.

Në varësi të llojit të ushqimit, tek dhitë mund të vihet re sa ushqim kanë lënë tepër në kullotë ose në grazhd. Edhe pse dhitë janë kapriçoze në ushqim, ka disa rregulla.

Tek dhitë, ushqimi mund të planifikohet në mënyrë që të merren të gjitha vlerat ushqimore të nevojshme. Edhe cilësia e ushqimit ka një rëndësi të veçantë, ushqimi i mirë i thatë është çelësi i një ferme ekonomike. Kashta dhe jonxha e mirë nxisin ngrënien, rrisin vlerat ushqimore dhe garantojnë një shfrytëzim optimal të lëndëve ushqimore. Kjo përkthehet në rendiment të mirë të prodhimit të qumështit, me pak koncentrat. Ushqimi i mirë bazë kursen koncentratin.

Ushqyerja në dimër, shembuj të racioneve të thjeshta (lënda e njomë)

Dhi qumështi 60 kg	Muaji i 5-të i shtatzanisë	Muaji i 2-të i laktacionit 5 kg qumësht	Pas muajit të 3-të të laktacionit 3 kg qumësht
Shembull 1	1,0 kg kashtë e mirë 0,45 kg bar shumë i mirë	0,45 kg kashtë e mirë 1,6 kg bar shumë i mirë 0,8 kg koncentrat energjie 0,2 kg koncentrat proteinik	0,3 kg kashtë e mirë 1,6 kg bar shumë i mirë 0,6 kg koncentrat energjie
Shembull 2	0,75 kg kashtë e keqe 0,5 kg bar mesatar 0,25 kg koncentrat energjie 0,1 kg koncentrat proteine	0,6 kg kashtë e keqe 1,0 kg bar mesatar 1,1 kg koncentrat energjie 0,45 kg koncentrat proteinik	0,6 kg kashtë e keqe 0,8 kg bar mesatar 1,0 kg koncentrat energjie 0,15 kg koncentrat protein
Shembull 3	1,25 kg kashtë e mirë 1,0 kg panxhar i bardhë	1,4kg kashtë e mirë 4,5 kg panxhar i bardhë 0,4 kg koncentrat 0,3 kg koncentrat proteinik	1,3kg kashtë e mirë 4,5 kg panxhar i bardhë 0,2kg koncentrat proteine
Shembull 4	0,8 kg kashtë mesatare 1,4 kg silazh bari 0,1 kg koncentrat proteine	0,7kg kashtë mesatare 3,1 kg silazh bari 0,9 kg koncentrat 0,25 kg koncentrat proteinik	0,7 kg kashtë mesatare 2,8 kg silazh bari 0,35 kg koncentrat 0,3 kg koncentrat proteine
Shembull 5	1,25 kg kashtë e mirë 0,7 kg briketa misri	1,25 kg kashtë e mirë 0,7kg briketa misri 0,55 kg koncentrat energjie 0,55 kg koncentrat proteinik	1,25 kg kashtë e mirë 0,5 kg briketa misri 0,7 kg koncentrat energjie
Shembull 6	1,1 kg kashtë e mirë 0,35 kg bar shumë i mirë	0,35 kg kashtë e mirë 1,45 kg bar shumë i mirë 4,5 kg panxhar i bardhë 0,3 kg koncentrat proteinik	0,2 kg kashtë e mirë 1,45 kg bar shumë i mirë 3,9 kg panxhar i bardhë



Në natyrë kafshët e kërkojnë ushqimin në bazë të instiktit dhe shijes. Për të arritur një rendiment të lartë të prodhimit të qumështit, duhet të shtohet koncentratit.

Sjellja e të ushqyerit

- Sjellje përzgjedhëse
- Preferencë për ushqim të imët me shumë gjethë
- Ngrënie e shpeshtë
- Periudha kohore e ngënies në mëngjes dhe mbasdite herët

Konsumi i ushqimit mund të rritet në qoftëse ushqimi jepet në mëngjes dhe mbasdite si dhe vënia në dispozicion gjatë ditës. Në fillim duhet t'i jepen ushqimet voluminoze dhe më pas koncentratit.

Konsumi i ushqimit

Për të vlerësuar konsumin e lëndës së thatë (LTH) për dhitë e qumështit mund të përdoret formula e mëposhtme:

$$LTH(kg/ditë) = 0,01 \times (\text{pesha } kg) + 0,9 + 0,4 \times (\text{kg qumësht} - 1)$$

Në dy muajt e parë të laktacionit, vlera e përlogaritur duhet të reduktohet me 10-15%.

- Për çdo rritje peshe prej 10 kg, konsumi i lëndës së thatë duhet të rritet me 100 g.
- Për çdo kg qumësht shtesë duhet të shtohet 400 g më shumë lëndë e thatë.

Për shkak të përmbajtjes së ulët të vlerave ushqimore të qumështit të dhisë, supozohet se dhitë kanë një nevojë relativisht të ulët për energji dhe proteina.

Këshilla ushqimi për dhitë e qumështit

- **Faza fillestare: Muaji i 1-rë dhe i 2-të i laktacionit.**

Karakteristika:

- Prodhim i lartë qumështi
- Nevojë më e lartë për vlera ushqimore dhe minerale (50 deri në 75% më shumë se gjatë shtatëzanisë)
- Konsumi i ushqimit reduktohet me 10-15%, pasi ngrënia e ushqimit rritet më ngadalë se sa nevoja për vlerat ushqimore.
- Shpërbërja e rezervave trupore kur prodhimi ditor shkon mbi 3 kg, rënie prej 8 kg në peshë
- Probleme të mundshme në lidhje me ushqimin: acetonemia, temperaturë e lartë.

Rregullat e të ushqyerit:

Me anë të cilësisë së ushqimit dhe teknologjisë së ushqyerjes duhet të arrihet një konsum sa më i lartë i ushqimit, në mënyrë që deficieti i energjisë të mbahet sa më i ulët të jetë e mundur.

- Përdorimi i ushqimit të mirë (bar, panxhar, etj)
- Koncentrati në doza të shpërndara gjatë ditës
- Doza e koncentratit duhet të rritet me rreth 200 g çdo javë, në mënyrë që të shmangen problemet me tretjen.
- Vënia e vazhdueshme e ushqimit në dispozicion rrit konsumin e ushqimit
- Racionet ushqimore me komponentë të ndryshëm (p.sh. kashtë, silazh bari, panxhar i peletuar) rrisin konsumin e ushqimit

Përbërja e ushqimit				
Ushqimi	Cilësia	% LTH	NEL MJ /kg LTH	APD g/kg LTH
Kashtë e mirë	A 2-4	88	5,4	86
Kashtë mesatare	A 2-5	88	5,0	78
Kashtë e keqe	A 2-7	88	4,4	65
Bar shumë i mirë	A 2-2	88	5,9	199
Bar mesatar	A 2-4	88	5,4	86
Koncentrat energjistik		87	8,0	100
Koncentrat proteinik		87	8,0	240
Koncentrat prodhimi		87	7,5	125
Panxhar i freskët		19	7,4	85
Silazh bari		35	6,4	84
Misër kokërr		90	6,3	85

Sistemet e ushqimit dhe mbarshtuesit e dhive

Forma e mbajtjes	Avantazhe	Disavantazhe
Në fermë me ushqim të freskët (të gjelbër)	Ushqyerje e rregullt, humbje të vogla ushqimi, problem i reduktuar i parazitëve	Shumë punë dhe makineri
Në kullota: kullota “evergreen”	Pa ndarje Më pak punë	Ushqim jo i rregullt, humbje të ushqimit, rreziku i tejngrënies, problem me parazitët
Kullota me rotacion (me shumë parcela)	Pak a shumë ushqyerje e rregullt, rrezik i ulët tejngrënies	Punë për zhvendosjen e ndarjeve, problem me parazitët
Kullota me porcion (intensive me procione ditore të freskëta)	Ushqim i rregullt , humbje të ulëta, rrezik i ulët tejngrënies	Shumë punë për ndarjet, probleme me parazitët
Të lira	Pak punë	Prodhim u ulët, ushqyerje e keqe

- Faza e prodhimit: Muaji i 3-të dhe i 4-rt i laktacionit

Karakteristika:

- Periudha e ngrënies së ushqimit bazë
- Marrje maksimale e ushqimit
- Nevoja për vlerat ushqimore mbulohet nga ushqimi bazë
- Krijimi i rezervave (rezervat trupore të shpërbëra gjatë periudhës së fundit të laktacionit rigjenerohen)

Rregullat e ushqimit:

- Ushqimi i mirë bazë kursen koncentratin
- Mbulim pa problem i nevojave
- Konsum maksimal i ushqimit me ulje të prodhimit të qumështit

Mos ushqeni së tepërmi kafshët të cilat prodhojnë pak qumësht gjatë përfundimit të laktacionit. (kafshët e shëndosha kanë lindje të vështira dhe prodhim të pamfjatueshëm të qumështit në fillim të laktacionit.

- Faza e riprodhimit dhe përgatitjes

Muaji i tretë i shtatzanisë e deri në lindje

Karakteristika:

- Rritje e shpejtë e fetusit
- Rritje e nevojës për vitamina dhe minerale për shkak të shtatëzanisë me rreth 40-100%.
- Rënie e konsumit të ushqimit (vëllim i kufizuar i stomakut)

- Përgatitje për laktacion

Rregullat e ushqimit:

- Ushqim bazë i mirë (mbi 5,5 MJ NEL/kg LTH)
- Furnizim i mirë me vitamina dhe minerale
- Futja e ngadaltë e koncentratit për përgatitje për laktacion (fillimi: 6 javë para lindjes, përshtatje me racionin e e dy muajve të parë të laktacionit)
- Sasia e koncentratit në periudhën e lindjes 200-300 g për ditë për të parandaluar problemet me metabolizmin e karbohidrateve.

Ushqimi i dhive të qumështit në dimër

E rëndësishme: furnizim i mjaftueshëm me minerale dhe ujë të freskët

Ushqimi në verë - kullota

Teknologjia e kullotave:

- Rregullim i ngadaltë i ushqimit, mikroorganizmat kanë nevojë të përshtaten për 1-2 javë
- Fillimi i kullotjes herët (shumë ushqim në dispozicion)
- Zmadhimi i sipërfaqes së kullotës në vjeshtë
- Kohë e gjatë qetësie

Kullota të mbyllura:

- Përshtatja e madhësisë së kullotës në varësi të kafshëve
- Max 1 javë kohë kullotjeje për kullotë
- Të paktën 5 kullota
- 3-5 javë kohë pritjeje për kullotë

Mineralet:

- Në zona malore shpesh ka mungesë P
- Në zona kodrinore shpesh ka mungesë Ca
- Blloqe kripe (Na)
- Elektrolite(> 50 mg për çdo kg peshë): Ca, P, Mg, K, Cl, S
- Mikroelementë (< 50 mg për çdo kg peshë): Fe, Cu, Mn, Zn, J, Co, Se, Mo, Cr
- Bllok kripe dhe mineralesh, ose në formë pluhuri, duhen përzierë me koncentratin.

Rritja e kecape

Dhitë mbahen kryesisht për prodhimin e qumështit. Për këtë arsye, pas lindjes kecat ndahen nga nëna e tyre. Duhet pasur shumë kujdes, që kecat e porsa lindur të pijnë kulloshtren sa më shpejt. Deri në ditën e 4-rt ai duhet të pijë kulloshtren e pasur me vitamina dhe antitropa. Për të qënë me eficientë ekonomikisht, është mirë që gjatë

periudhës së pirjes së qumështit, qumështi i dhisë të zvendësohet me qumësht pluhur, i cili kushton më pak. Duke e ushqyer që herët me lëndë të thatë, përshpejtohet zhvillimi i stomakut ripërthypës. Pra, pas javës së tretë, ushqimi dhe uji duhet të jetë lirisht në dispozicion. Temperatura e pirjes duhet të mbahet patjetër 40° C.

Ushqimi i dhive të vogla femra

Pas ndërprerjes së qumështit (rreth 8 javë pas lindjes), dhitë e vogla duhet të marrin 300 g koncentrat, për të garantuar një rritje të njëtrajtshme. Racioni i koncentratit, më pas duhet të reduktohet gradualisht. Në qoftë se ushqimi bazë është cilësor, në muajin e pestë nuk ka më nevojë për koncentrat. Në muajin e 7-të, dhia duhet të ketë një peshë prej 35 kg, në mënyrë që të inseminohet.

Ushqimi i kecape meshkuj

Përveç periudhës së pjekurisë seksuale, nevoja për vlera ushqimore është e ulët, në qoftë se cilësia e ushqimit është e mirë, nuk është e nevojshme të shtohet koncentrat. Gjatë kohës pjekurisë seksuale, konsumi i ushqimit dhe nevoja për vitamina dhe minerale rritet, kështu që gjatë kësaj periudhe duhet të shtohet edhe koncentrat (300 g).

Kufizime të ushqimit

- Bërsi molle, deri në 0,9 kg LTh(lëndë e thatë) për ditë, e freskët ose si silazh, kujdes cilësinë
- Lakra: max 0,5 kg LT në ditë, jo për keca pasi i dëmton dhe ndikon në shijen e qumështit
- Panxhar i freskët: deri në 0,7 kg LT në ditë, vetëm panxhar të mirë dhe të konservuar mirë, të prerë në copa.
- Drithëra: preferohen elbi dhe tërshëra, të shtypura ose të grira
- Bar: deri në 1,9 kg në ditë, silazh vetëm me cilësi të mirë dhe plotësoni racionin me kashtë
- Tërshërë jeshile: 0,5 – 1,0 kg në ditë, përzierje me kashtë
- Patate: deri në 0,6 kg në ditë, jo patate jeshile ose që kanë çelur (diarre, ekzema), të shtypura hahen më mirë sesa të copëtuara
- Silazh misri: mundësisht vetëm në gjysmën e parë të laktacionit, plotësim me 0,5 kg LT kashtë
- Gjethe: deri në 0,5 LT për ditë, shpesh janë të pasura me vitamina dhe minerale
- Hurrë vetëm për dhitë e rritura, (jo për keca): deri në 4,5 litër në ditë,
- Gjethe panxhari: deri në 0,5 kg LT në ditë me kashtë, të freskët ose të silazhuar, përmbajtje të lartë proteinike dhe fibre.

Shembuj racionesh për keca për qumësht dhe majmëri.

Mosha	Qumësht pluhur Në ditë	Qumësht dhie Në ditë
Deri në 4 ditë	2 x 750 g kulloshtër	2 x 750 g kulloshtër
5-7 ditë	2 x 750 g përzierje (1/2 kulloshtër, 1/2 qumësht pluhur)	2 x 750 g kulloshtër
Javën e dytë	2 x 750 g	2 x 750 g
Javën e tretë	2 x 800 g	2 x 1000 g
Javën e katërt	2 x 800 g	2 x 1000 g
Javën e pestë	2 x 600 g	2 x 800 g
Javën e gjashtë	1 x 300 g	2 x 700 g
Javën e shtatë		1 x 300 g
Javën e tetë		